



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 26
Prishtinë, më 28 korrik 2011

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 28 KORRIK 2011**

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Në fillim të mbledhjes, Kuvendi, me propozim të Kryetarit, në shenjë nderimi për Heroin më të ri të Kosovës, Enver Zymberi, mbajti një minutë heshtje.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 77 deputetë dhe deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare. Ai i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Pasta, Kryetari fjalën ia dha kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi.

Kryeministri, **Hashim Thaçi**, i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me zhvillimet e fundit në veriun e Kosovës.

Në vazhdim, kryeministri tha se Qeveria e Republikës së Kosovës, javën e kaluar, duke respektuar Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, ka marrë vendim për aplikimin e masave të reciprocitetit për mallrat që janë importuar nga Serbia dhe Bosnja Hercegovina.

Ky vendim ka filluar të zbatohet në të gjitha pikat kufitare menjëherë, në përjashtim të pikës 1 dhe 31.

Unë si kryeministër kam autorizuar Policinë e Kosovës, që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për vendosjen e sundimit të ligjit dhe zbatimin e vendimit për reciprocitet në pikën 1 dhe 31.

Policia e Kosovës ka filluar operacionin dhe pas përfundimit me sukses të njësisë speciale në veri të vendit, ato janë tërhequr dhe Policia Kufitare dhe doganieret janë vendosur në pikën 1 dhe 31, për ta kryer punën e tyre normale të kontrollit kufitar. Gjatë ballafaqimit për vënien e rendit dhe ligjit heroikisht ka rënë në krye të detyrës në mbrojtje të Kushtetutës, ligjit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës, Enver Zymberi.

Fatkeqësisht, dje në orët e pasdites, një grup i organizuar kriminal i udhëhequr nga liderët e strukturave paralele serbe dhe autoritetet e Beogradit, kanë sulmuar fillimisht pikën 1, e më pas në orët e mërkurës atë 31.

Pika 1 është djegur dhe dëmtuar në masë të madhe kontejnerët, ndërsa pika 31 është mbrojtur nga forcat e KFOR-it dhe ato të Policisë së Kosovës.

Këto veprime të dhunshme të bandave kriminale janë urdhëruar, koordinuar dhe të udhëhequra nga strukturat me të larta politike të Beogradit.

Forcat e KFOR-it dhe Policia e Kosovës kanë mbajtur kontrollin në pikën 31, ndërsa pika 1 është rimarr nga forcat e KFOR-it dhe aktualisht është mbyllur për qarkullim. Qeveria e Kosovës është e vendosur të ndërmarrë veprime të menjëhershme qysh sot për të riparuar logjistikën e dëmtuar në pikën 1, me qëllim që aty të dërgohen përsëri menjëherë oficerët e Policisë Kufitare të Kosovës, së bashku me doganierët.

Në asnjë rrethanë dhe me asnjë çmim nuk do të ketë asnjë hap mbrapa. Nuk do të ketë rikthim prapa në gjendjen e para 4 ditësh, nuk do të ketë rikthim prapa në gjendjen e statuskvos, nuk do të ketë rikthim në gjendjen e mëhershme. Qeveria e Republikës së Kosovës është e konsultuar dhe koordinuar me gjithë faktorët që punojnë për rend, ligj, respektim të Kushtetutës së Kosovës dhe ligjet e Kosovës.

Masat e reciprocitetit me Serbinë do të instalohen dhe zbatohen në gjitha pikat kufitare me Serbinë dhe kjo do të zgjasë derisa Serbia nuk ndryshon qëndrimin e saj.

Dua t'ju siguroj se skenari i Serbisë për ndarjen e veriut të Kosovës, nuk do të ndodhë kurrë dhe me asnjë çmim.

Unë i falënderoj gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, ju falënderoj gjithë juve, gjithë spektrin politik për mesazhe të urta, të matura, për ruajtjen e qetësisë, për mirëkuptimin dhe besimin tek institucionet e shtetit të Kosovës.

Kryetari i GP të PDK-së, **Adem Grabovci**, tha se të gjithë jemi të shqetësuar dhe kemi përcjellë me vëmendje dhe seriozitetin më të madh rrjedhën e ngjarjeve në veri të vendit. Deputetët e të gjitha grupeve parlamentare t jemi dakorduar që sot të mbahet një seancë e

jashtëzakonshme ku do të debatohet dhe do të nxirret një rezolutë në përkrahje të vendimeve dhe veprimeve të Qeverisë së Kosovës, për vënien e rendit dhe ligjit në tërë territorin e Kosovës.

Ai propozoi që Kuvendi në mbledhjen e sotme t'i heq nga rendi i ditës dy pikat e para: Deklarimet jashtë rendit të ditës dhe Pyetjet parlamentare dhe në pikën e parë të kemi një debat mbi gjendjen në veri të vendit dhe nxjerrjen e një rezolute.

Kryetari kërkoi qëndrimin e grupeve parlamentare lidhur me propozimin e kryetarit të GP të PDK-së.

Në emër të GP të LDK-së, **Ismet Beqiri**, tha se e përkrahin Mocionin e kryetarit të GP të PDK-së, për të debatuar për gjendjen në veri të Kosovës, si dhe propozimin për heqjen e pikave të para të rendit të ditës.

Në emër të GP të “Vetëvendosjes”, **Visar Ymeri**, tha se Lëvizja “Vetëvendosje” mendon që sot duhet të debatohet vetëm për gjendjen në pjesën veriore të vendit. Kuvendi duhet të debatohet jo vetëm dy orë, por sado që ka nevojë dhe ta përfundojmë këtë me një rezolutë të përbashkët.

Në emër të GP të AAK-së, **Ardian Gjini**, tha se mbështet propozimin që Kuvendi sot të debatohet për situatën në veri të Kosovës, si dhe nxjerrjen e një rezolute apo deklaratë të përbashkët.

Në emër të GP Koalicioni për Kosovë të Re, Myzejane Selmani, tha se pajtohet me paraqitjen të diskutohet për gjendjen në veri të vendit, si dhe të miratohet një rezolutë e përbashkët e Kuvendit.

Në emër të Grupit “6+”, Enis Kervan, tha se përkrahin propozimin që Kuvendit, sot të debatohet për gjendjen në veri të Kosovës.

Kryetari tha se janë paraqitur dy mocione. Njërin deputetit Adem Grabovci dhe një ndryshim është në kërkesën e GP “Vetëvendosje”.

Fillimisht, Kryetari hodhi në votim Mocionin e GP të PDK-së. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----shumica absolute,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi vendosi që të mbahet seancë e posaçme për të debatuar për gjendjen aktuale në veri të Kosovës, ndërsa pas përfundimit të kësaj mbledhje, do të vazhdohet me mbledhjen tjetër, sipas rendit të ditës të caktuar nga Kryesia e kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare.

Kryetari dha pauzë 15 minuta.

(Kuvendi mbajti seancë të jashtzakonshme, në të cilën debatoi për gjendjen aktuale në veri të Kosovës, si dhe nxori një rezolutë prej 7 pikave. Pas përfundimit të mbledhjes së jashtzakonshme, Kuvendi i vazhdoi punimet me mbledhjen e rregullt)

Mbledhja e rregullt Kuvendit i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
2. Ratifikimi i Marrëveshjes për Llogarinë e Trustit në mes të Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Republikës së Kosovës lidhur me ndihmën zhvillimore përmes Programit për Arsim Themelor,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e Duhanit,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zjarrfikje dhe shpëtim,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e informatorëve,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për masat mbrojtëse të importeve,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Organizimin Sindikal,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Kadastrën,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për markat tregtare,
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dizajnin industrial,
14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për patenta,
15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përdorim civil të eksplozivëve

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur me 21 korrik 2011

Kuvendi miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare të datës 21 korrik 2011, pa vërejtje.

2. Ratifikimi i Marrëveshjes për Llogarinë e Trustit në mes të Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Republikës së Kosovës lidhur me ndihmën zhvillimore përmes Programit për Arsim Themelor

Kryetari i Kuvendit i njoftoi deputetët e Kuvendit se Presidentja e republikës së Kosovës kishte nënshkruar Marrëveshjen për Llogarinë e Trustit në mes të Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Republikës së Kosovës lidhur me ndihmën zhvillimore përmes Programit për Arsim Themelor.

Marrëveshja e lartpërmendur i është dërguar deputetëve të Kuvendit vetëm për njoftim.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre

Kryetari, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur me 26 korrik 2011, ka propozuar që shqyrtimi i parë i këtij projektligji të bëhet me procedurë të përsheptuar, andaj kërkoi nga deputetët deklarimin me votim për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, në pajtim me nenin 84 të Rregullores së Kuvendit.

Kuvendi miratoi propozimin e Kryetarit për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, në pajtim me nenin 84 të Rregullores së Kuvendit.

Kryetari, në vazhdim ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që të prezantojë dhe arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre.

Kryeministri, **Hashim Thaçi**, fillimisht tha se ky Projektligj ka qenë edhe më herët i proceduar në Kuvend, por për shkak të zhvillimeve politike ka ndodhur që të kthehet përsëri në Qeveri.

Në vazhdim, kryeministri theksoi se qëllimi i nxjerrjes së këtij Projektligji është përcaktimi i statusit dhe përkrahja financiare për kategoritë e veçanta të dala nga lufta e UÇK-së, invalidëve civilë, viktimave civile të luftës dhe kategorive të tjera, të cilët me sakrificën dhe kontributin e tyre ishin faktorë determinues për çlirimin e vendit.

Projektligji parasheh që për kategoritë e caktuara të sigurohen këto pensione: pensioni familjar të cilin e realizon familja e ngushtë e dëshmorit e të zhdukurit e të pagjeturit të UÇK-së, e viktimës civile të luftës si dhe familjet e të zhdukurit civil, pensioni invalidor personal, të cilin e realizon invalidi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe invalidi civil i luftës në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë ligj, pensioni invalidor familjar të cilin e realizon familja e ngushtë pas vdekjes së invalidit, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë ligj, si dhe rritja e pensioneve për kategoritë e trajtuara në projektligj, sqaroi kryeministri Thaçi.

Gjithashtu, me këtë projektligj përcaktohet baza ligjore për themelimin e një komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të gjitha kategorive të trajtuara me këtë projektligj, që do të përbëhet nga përfaqësuesit e institucioneve kompetente për këtë çështje, Zyrës për çështje të veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, tha ai.

Më tutje, kryeministri shpjegoi lidhur me një lëshim teknik i cili ka ndodhur në Projektligj, duke theksuar se për kategoritë e parapara në këtë Projektligj, bëhet fjalë për periudhën kohore që nga viti 1945 e deri në përmbyllje të luftës së UÇK-së.

Në fund të fjalës së tij kryeministri u fokusua në rolin unifikues që bart në vete ky Projektligj, duke potencuar posaçërisht të gjitha etapat e përpjekjeve për çlirim kombëtar dhe pavarësinë e Kosovës që nga viti 1945, përfshirë lëvizjen e udhëhequr nga simboli i rezistencës kombëtare, Adem Demaçi, lëvizjen e vitit 1968, demonstratat e vitit 1981 dhe ato të vitit 1989-1990, rezistencën dhe padëgjueshmërinë qytetare dhe civile të viteve 1990-1998 dhe kulminacionin i rezistencës për liri të plotë nga Serbia me Luftën e UÇK-së dhe gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Në përmbyllje të fjalës së tij, ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, deputeti, Fikrim Damka, në emër të grupit Parlamentar të PDK-së, Bekim Haxhiu, në emër të grupit Parlamentar të LDK-së, Anton Çuni, në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje, Rexhep Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Suzana Novoberdaliu, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6”, Enis Kervan, si dhe deputetët: Sabri Hamiti, Agim Kuleta, Jakup Krasniqi, Time Kadrijaj, Armend Zemaj, Hydajet Hyseni, Ardian Gjini, Justina Shiroka-Pula, Haki Demolli, Blerta Deliu-Kodra dhe Ramiz Lladrovci, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 59,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e Duhanit

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e Duhanit.

Ministri, **Blerand Stavileci**, tha se ky Projektligj përcakton parimet dhe procedurat për rregullimin e prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe tregtimit të duhanit të papërpunuar dhe produkteve të tij në Republikën e Kosovës.

Në vazhdim, tha se fushëveprimi i këtij projektligji ka të bëjë me marrëdhëniet juridike të subjekteve të cilat merren me prodhimin, grumbullimit, përpunimit dhe tregtimit të duhanit.

Më tej, ai shpjegoi arsyet e nxjerrjes së këtij Projektligji të cilat qëndrojnë në mungesën e një Ligji i cili do ta rregullonte zhvillimin e kësaj veprimtarie ekonomike.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e Duhanit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, deputeti, Nait Hasani, në emër të grupit Parlamentar të PDK-së, Nijazi Idrizi, në emër të grupit Parlamentar të LDK-së,

Sali Morina, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Time Kadrijaj, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Myzejene Selmani, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6”, Albert Kinolli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 56,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e Duhanit.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zjarrfikje dhe shpëtim

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për zjarrfikje dhe shpëtim.

Ministri, **Bajram Rexhepi**, tha se arsyeja e nxjerrjes së këtij Projektligji qëndron në faktin se aktualisht në legjislacionin e Republikës së Kosovës nuk ekziston ndonjë ligj i cili do ta rregullonte këtë fushë në tërësi.

Ai sqaroj më tej se fusha e zjarrfikjes deri më tani ka qenë e rregulluar pjesërisht me Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri, e cila nuk e ka mbuluar në tërësi fushëveprimin e zjarrfikjes dhe shpëtimit e njerëzve dhe pasurisë së tyre në situata emergjente.

Në vazhdim, tha se ky projektligj adreson detyrat që duhet të përmbushen nga njësitë e zjarrfikjes dhe shpëtimit që do të themelohen dhe synohet sigurimi i mekanizmave reagues efektiv për zjarrfikje me qëllim të shpëtimit të njerëzve dhe pasurisë në situata emergjente.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për zjarrfikje dhe shpëtim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e forcës së Sigurisë së Kosovës, dhe në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti, Ahmet Isufi, në emër të grupit Parlamentar të PDK-së, Fadil Demaku, në emër të grupit Parlamentar të LDK-së, Vjollca Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Suzana Novoberdaliu, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6”, Albert Kinolli, si dhe ministri Bajram Rexhepi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 43,
Kundër----- 13,
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për zjarrfikje dhe shpëtim.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e forcës së Sigurisë së Kosovës, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e informatorëve

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për mbrojtjen e informatorëve.

Zv. kryeministri dhe ministër i drejtësisë, **Hajredin Kuçi**, tha se iniciativa për hartimin e Projektligjit për mbrojtjen e informatorëve është në harmoni të plotë me përkushtimin e Qeverisë për kompletimin e infrastrukturës ligjore në fushën e mbrojtjes së informatorëve dhe eliminimin e zbrastësirave ligjore të cilat aktualisht ekzistojnë në Kosovë.

Ai sqaroi më tej se përmes këtij projektligji synohet të rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e besueshme nga çdo formë e hakmarrjes së informatorëve, dhe projektligji paraqet një mundësi të mirë për të forcuar përgjegjësinë dhe përkrahjen e luftës kundër korrupsionit dhe keqadministrimit, në sektorin publik dhe privat, me qëllim të vendosjes së një rendi kushtetues dhe ligjor të besueshëm për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Në vazhdim, Zv. kryeministri u fokusua në adresimin e këtij projektligji duke përmendur një varg Institucioneesh të larta të Republikës së Kosovës, siç janë Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Kosovës, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, etj.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për mbrojtjen e informatorëve.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të grupit Parlamentar të PDK-së, Behar Selimi, në emër të grupit Parlamentar të LDK-së, Haki Demolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Suzana Novoberdaliu, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar "6", Myfera Shinik, si dhe Zv. kryeministri dhe ministër i drejtësisë, Hajredin Kuçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 58,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për mbrojtjen e informatorëve.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për masat mbrojtëse të importeve

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për masat mbrojtëse të importeve.

Zv. kryeministri, **Hajredin Kuçi**, tha se arsyeja për hartimin e këtij Projektligji qëndron në faktin se pas miratimit të tij, krijohen mundësi për përmirësimin e ambientit të biznesit, konkretisht në: mbrojtjen e prodhimeve vendore nga praktikat mashtruese dhe jo të drejta tregtare, nxitjen e konkurrencës së barabartë në treg, rregullimin dhe funksionimin e tregut, nxitjen e eksportit dhe investimeve, përmirësimin e bilancit të shkëmbimeve tregtare, etj.

Ai, sqaroi më tej se përmes këtij projektligji synohet të rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me parimet dhe procedurat lidhur me marrjen e masave mbrojtëse në rastet kur një produkt importohet në Kosovë në sasi të mëdha sa që shkakton dëm serioz për prodhuesit vendor të mallrave të ngjashme ose identike me kusht që këto masa të jenë të përkohshme dhe të vazhdueshme.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për masat mbrojtëse të importeve.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti, Zenun Pajaziti, në emër të grupit Parlamentar të PDK-së, Berat Buzhala, në emër të grupit Parlamentar të LDK-së, Teuta Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Myzejene Selmani, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6”, Fikrim Damka, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 59,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për masat mbrojtëse të importeve.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për prokurimin publik në Republikën e Kosovës.

Zv. kryeministri, **Hajredin Kuçi**, tha se qëllimi i këtij Projektligji është të sigurojë mënyrën më efikase, transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, sigurimin e integritetit dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë të përfshirë në aktivitetet të prokurimit, si dhe të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar dhe të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme dhe etike në mesin e personave zyrtarë të përfshirë në një aktivitet prokurimi. Ai, sqaroi më tej, se fushëveprimi i këtij Projektligji do të vlej për të gjitha aktivitetet e prokurimit dhe koncesionarëve të punëve, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, të cilët kërkohet të veprojnë në përputhje me kërkesat procedurale dhe materiale të këtij Projektligji.

Në fund ai kërkoi miratimin në parim të Projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja, Safete Hadergjona, në emër të grupit Parlamentar të PDK-së, Hasime Krasniqi, në emër të grupit Parlamentar të LDK-së, Hikmete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaç-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Suzana Novoberdaliu, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6”, Fikrim Damka, si dhe Zv. kryeministri, Hajredin Kuçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 57,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për prokurimin publik në Republikën e Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Organizimin Sindikal

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për Organizimin Sindikal.

Raportin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, e arsyetoi anëtarja e këtij komisioni, deputetja, Salihe Mustafa.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e znj. Mustafa, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33 dhe amendamentin nr. 34.
Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	59,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për Organizimin Sindikal.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, e arsyetoi kryetarja e këtij komisioni, deputetja, Safete Hadergjonaj.
Pas arsyetimit të raportit nga ana e znj. Hadergjonaj, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kryesuesi, në mungesë të kuorumit për të proceduar me votim të këtij Projektligji, propozoi të përfundojë mbledhja e sotme plenare, për të vazhduar ditën e nesërme me dt. 29 korrik, në orën 10:00.
Kuvendi miratoi propozimin e kryesuesit.

Vazhdimi i mbledhjes plenare E premte, 29 korrik 2011, ora 10:00

Mbledhjen e kryesoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryesuesi deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare të filluar me datë 28 korrik 2011. Ai tha se në radhë është pika nr. 10 e rendit të ditës-

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim

Deputeti, Sabri Hamiti, propozoi që Kuvendi amendamentet e Projektligjeve të cilat janë sot në shqyrtim, të votohen me ngritje dore, për shkak të ritmit më të shpejt të punës.

Kryesuesi kërkoi nga Kuvendi që të deklarohet për propozimin e deputetit Hamiti.

Kryesuesi, konstatoi se Kuvendi miratoi propozimin e deputetit Sabri Hamiti, që Kuvendi të votoj me ngritje dore amendamentet e Projektligjeve të cilat janë sot në shqyrtim të dytë.

Kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, dhe amendamentin nr. 18.

Deputeti, Ardian Gjini, propozoi që amendamenti nr.10 të mos votohet, por të mbetet versioni i ofruar nga Qeveria, në nenin 13 të këtij Projektligji.

Kuvendi nuk miratoi amendamentin nr. 10.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 70,
Kundër----- 3,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Kadastrën

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për Kadastrën.

Raportin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, e arsyetoi anëtar i këtij komisioni, deputeti, Liburn Aliu.

Pas arsyetimit të raportit nga ana e z. Aliu, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, dhe amendamentin nr. 22.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 62,
Kundër----- 9,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për Kadastrën.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për markat tregtare

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për markat tregtare.

Pasi që nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, dhe amendamentin nr. 12.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 64,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për markat tregtare.

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dizajnin industrial

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për dizajnin industrial.

Pasi që nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, dhe amendamentin nr. 9. Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 65,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për dizajnin industrial.

14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për patenta

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për patenta.

Pasi që nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, dhe amendamentin nr. 10. Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 68,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për patenta.

15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përdorim civil të eksplozivëve

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për përdorim civil të eksplozivëve.

Pasi që nuk pati deputetë të paraqitur për diskutim, kryesuesi hodhi në votim, një nga një, amendamentet e propozuara.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, dhe amendamentin nr. 42.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 65,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për përdorim civil të eksplozivëve.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për çështje plenare dhe procedurale